



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org. Unit	SP-02	Nr. i Prot. Broj Prot.	511-2/24
Nr. i Faqeve Br. Stranica	04	Datë Datum	19.03.24
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	11.03.2024
REFERENC-Ë:	24/511/60/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Transfer i lejës mjedisore nga operatori "Cats Recycler" SH.P.K. - Vushtri Për riciklim të katalizatorëve
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Transfer të Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me nr. prot. 24/511/60/DMMU-MMPHI, të operatorit "Cats Recycler" SH.P.K. - Vushtri Për riciklim të katalizatorëve

Operatori, "Cats Recycler" SH.P.K., Vushtri Për riciklim të katalizatorëve, ka bërë kërkesë për transferin e Lejes Mjedisore me nr. 22/6784/MMPHI, të lëshuar me datë : 17.01.2023, nga kompania "Cats Recycler" SH.P.K. në kompaninë "Kos Cat Recycler" SH.P.K, Vushtri sipas kodit 160801 në zonën kadatsrale Vushtri.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. **Vendimi për Transferin e Lejes Mjedisore** më Nr.23/6784/ZSP//23, të lëshuar me dt. 17.01.2023.
2. Vendimin për transferin e Pëlqimit Mjedisor, me nr.prot. 23/7396/ZSP/24, të datës: 11.01.2024.
3. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga ARBK, me NUI-811402974 , të datës: 25.02.2020, në emër të kompanisë CATS RECYCLER sh.p.k dhe
4. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga ARBK, me NUI-812108779 , të datës: 13.12.2023, në emër të kompanisë, KOS CAT Recycler , sh.p.k.

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/511/60/MMPHI
Datë: 11.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 18 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore dhe neni 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "Cats Recycler" SH.P.K. - Vushtri i transferohet Leja Mjedisore me Nr.23/6784/ZSP//23, te lëshuar me dt. 17.01.2023, në operatorin "Kos Cat Recycler" SH.P.K, Vushtri.
2. Kompania, "Kos Cat Recycler" SH.P.K, Vushtri, si trashëguese e këtij Vendimi është e obliguar ti përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga Leja Mjedisore me Nr.23/6784/ZSP//23, te lëshuar me dt. 17.01.2023.



Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës të operatorit "Cats Recycler" SH.P.K. – Vushtri i transferohet Leja Mjedisore me Nr.23/6784/ZSP//23, të lëshuar me dt. 17.01.2023, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore, nga takimi i mbajtur me dt. 11.03.2024, konstatoi se Operatori i plotëson kriteret e parapara për transferin e Lejes Mjedisore në përputhje me nenin 18 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për transferin e Lejes Mjedisore me Nr.23/6784/ZSP//23, të lëshuar me dt. 17.01.2023, në operatorin "Kos Cat Recycler" SH.P.K, Vushtri.

Vendimi i transferit të Lejes Mjedisore, vlenë për periudhën e caktuar në Vendimin e Lejes Mjedisore ekzistuese.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Vushtri;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Mjështetë Org. Jedinica Org. Unit	<u>DMMU</u>
Nr. i Faqeve Nr. Stranica No. Pages	<u>1</u>
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	<u>511-2/24</u>
Data Datum Date	<u>11.03.24</u>
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	24/511/60/MMPHI /DMMU
DATE/A:	11.03.2024
PËR/ZA/TO:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Abdullah Pirçe, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU
NGA/OD/FROM:	Fatlije Buza, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Transferin e lejës mjedisore nga operatori "Cats Recycler" SH.P.K. - Vushtri, Për riciklim të katalizatorëve në operatorin "Kos Cat Recycler" SH.P.K, Vushtri.

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokoli: nr. prot. -24/511/60/MMPHI /DMMU të operatorit " Cats Recycler" SH.P.K. - Vushtri" SH.P.K, Për riciklim tkatalizatorëve
Me respekt,